

Numri i lëndës: 2023:299273

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05421157

C.nr.574/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.M.nga G., të përfaqësuar nga S.B., avokat në V., kundër të paditurës Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 926.10 €, jashtë seancës, me datë 05.03.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.M.nga G. dhe detyrohet e paditura Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, për 343 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 22.01.2021 deri më 22.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 686 € dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 240.10 €, të gjitha në shumë të përgjithshme 926.10 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën 125 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Arsyetim

Me datë 26.12.2023, përfaqësuesi i paditëses, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës, me të cilën ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në ShFMU "Dëshmorët e V." në V. andaj nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditëses në emër të shpenzimeve për ushqim dhe udhëtim, për 343 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 22.01.2021 deri më 22.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 686 € dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 240.10 €, të gjitha në shumë të përgjithshme 926.10 €, në afat prej 7 ditësh. Si prova, padisë i ka bashkëngjitur: Vërtetimin e lëshuar nga shkolla "Dëshmorët e V.", nr.86/23, të datës 06.09.2023, Kartelën e SBASHK-ut, Vërtetimin e lëshuar nga shkolla "Dëshmorët e V.", nr.74/23, të datës 02.04.2021, Certifikatën e vendbanimit B 10499385, të datës 06.11.2023, Vërtetimin e kompanive të transportit të udhëtarëve për V. si dhe Kërkesën drejtuar Drejtorisë Komunale për Arsim në V.. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar edhe atë shumën prej 21 € për taksën gjyqësore për padi dhe shumën prej 104 € për përpilimin e padisë, të gjitha në shumën 125 €.

E paditura, me përgjigje në padi, e ka kundërshtuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se nuk është përgjegjëse për detyrimet nga Kontrata Kolektive e V.t 2017 pasi pagat dhe mëditjet paguhen nga ministria përkatëse e poashtu, tutje ka pretenduar se Qeveria dhe Ministria e Arsimit e kanë shfuqizuar Kontratën Kolektive (tutje KK) të SBASHK-ut, nr. 105, të datës 22.01.2021 si dhe KK paraprake nr. 01B/2056, të datës 21.11.2022 prandaj edhe nuk rrjedh asnjë obligim për të paditurën ndaj paditëses. Lidhur me shpenzimet procedurale, nuk është deklaruar.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese: ekzistimi i marrëdhënies së punës si dhe fakti se paditësja ka qenë e pranishme në punë 343 ditë, përkatësisht nga data 22.01.2021-22.11.2022 dhe se gjatë kësaj periudhe kohore ka udhëtuar në relacionin Gjilan¹-V. dhe anasjelltas, pasi e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin është përcaktuar se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë” dhe ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditëses.

Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, lidhur me nenin 35, par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK-së), të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim” dhe par. 5 të të njejtit nen, i cili përcakton se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

¹ Gjykata ka llogaritur hyrjen nga fshati Budrikë, që është fshat i Komunës së Vitisë e për të cilën çmimi i biletës kushton 0.50 cent (vërtetuar nga çmimorja e biletave të kompanive të transportit në Viti).

Lidhur me kamatën gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, i cili ka përcaktuar: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është 8% (tetë përqind) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Gjithashtu, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 449 lidhur me nenin 452.1 dhe 463.1 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin dhe për këtë arsye u detyrua të paguajë shpenzimet e paditëses edhe atë, për taksën gjyqësore për padi shumën 21 € dhe për përpilimin e padisë shumën prej 104 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.

C.nr.574/2024, Datë 05.03.2024

Gjyqtari,
Alush Sinani

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.